

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrogat e gjyqtarëve/ Pas festës së ngrohtë të Vajzës, Sokol Sadushi ndihet “i tradhëtuar” nga Edi Rama
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/10/rrogat-e-gjyqtareve-pas-festes-se-ngrohte-te-vajzes-sokol-sadushi-ndihet-i-tradhetuar-nga-edi-rama/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 09:20:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 09:17:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d80c1c1f5f16a6bd566ba299b241329ff0457fc2c7a1971533c8867c82e2cae4
TEKSTI	2cfcb5e13dbcc62c4eb637fc72660305314dd81bfaf32be97b8bc5907237c45e
PAMJA	a85ec8f86954b28194da2beba9a73a7d7cd6ea3d8a3cf500f69462c84104e3e8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ace0a3024a804bc49f54ececab368263ab4050d9bad688945165ed1f3ba8708
E MËPARSHMJA	18ff2522ef6b116afac1c70c34719f1adfe56173506ca51289fa9cd03c9eca17
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ace0a3024a804bc49f54ececab368263ab4050d9bad688945165ed1f3ba8708>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [KRYESORE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [OP-ED](#)
- [VETTING](#)
- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKE](#)
- [SPORT](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [TE TJERA](#)
 - [PRIVACY POLICY](#)
 - [KONTAKT](#)
 - [EKONOMI](#)
 - [SHENDETI](#)
 - [SHOW BIZ](#)
 - [KULTURE](#)
 - [POLITIKE](#)
 - [KRONIKE](#)
 - [TEKNOLOGJI](#)
 - [VIDEOT KRYESORE TE DITES](#)
 - [VIDEO](#)
 - [BOLD BLOG](#)
 - [FOTOGRAFI](#)
 - [HOROSKOPI](#)
 - [NDRYSHE](#)
 - [RAJONI](#)
 - [BOTA](#)
 - [SOCIALE](#)
- [ZGJEDHJE 2025](#)

- [KRYESORE](#)

•
[Fillimi](#) [AKTUALITET](#)

Rrëgat e gjyqtarëve/ Pas festës së ngrohtë të Vajzës, Sokol Sadushi ndihet “i tradhëtuar” nga Edi Rama

11:17 : 10/09/2026
në [AKTUALITET](#), [KRONIKE](#)

- - [Botërori 2026](#)
- - [PRIVACY POLICY](#)
 - [KONTAKT](#)
 - [EKONOMI](#)
 - [SHENDETI](#)
 - [SHOW BIZ](#)
 - [KULTURE](#)
 - [POLITIKE](#)
 - [KRONIKE](#)
 - [TEKNOLOGJI](#)
 - [VIDEOT KRYESORE TE DITES](#)
 - [VIDEO](#)
 - [BOLD BLOG](#)
 - [FOTOGRAFI](#)
 - [HOROSKOPI](#)
 - [NDRYSHE](#)

- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [SOCIALE](#)

•

Në një atmosferë të ngrohtë dhe festive, pak ditë më parë, kryeministri Edi Rama dhe kryetari në largim i Gjykatës së Lartë, Sokol Sadushi, u shfaqën së bashku në [Festivalin “Vajza”](#), në Vlorë, një moment ku dominuan batutat, buzëqeshjet dhe falënderimet publike.

Rama nuk kurseu vlerësimet për Sadushin, duke e falënderuar publikisht për kontributin e tij, duke lënë të kuptohet një marrëdhënie tejet e afërt dhe miqësore mes tyre.

“Dhe në radhë të parë dua të falënderoj Sokolin, i cili më dërgoi ftesën për të katërtin vit rresht. Dhe këtë herë nuk refuzova, duke qenë se tani më, siç e tha edhe gjyqtarja, e cila i uroj që gjykimi të ketë formën e prerë, 4 vjet janë mjaft për të pasur besim që idea funksionon. Kështu që besoj që është rradha e duhur për të ardhur dhe për të dëshmuar, së bashku me të tjerët, suksesin e një ideje të lindur 4 vjet më parë”, - u shpreh Rama.

Por vetëm pak ditë më vonë, situata duket krejt ndryshe.

Në mbledhjen e jashtëzakonshme të gjyqtarëve të mbajtur mëngjesin e kësaj të enjteje në KLGJ, ku u diskutua mbi rrogat e gjyqtarëve, Sadushi mbajti një qëndrim tjetër përballë situatës, duke e vendosur theksin te përgjegjësia e shtetit për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Lexo edhe:

[Ngërçi me pagat/ Magjistratët kallëzojnë në SPAK, Petrit Malajn dhe drejtuesit e Thesarit në rrethe](#)

[Rama takim me drejtuesit politikë/ Mbledhje me dyer të mbyllura te “Vila e Kuqe”](#)

Pa e përmendur drejtpërdrejt Edi Ramën, Sadushi foli qartë për ekzekutivin dhe mënyrën se si po trajtohet çështja e pagave, duke lënë të nënkuptohet se ndjehet “i tradhëtuar” nga kreu i qeverisë, i cili pak ditë më parë i thuri lavde.

“Paga nuk është një shpërblim, që jepet sipas vlerësimit të ekzekutivit dhe as një instrument që mund të përdoret për të ndikuar mbi gjyqësorin. Në një shtet të së drejtës nuk është Kushtetuta ajo që përshtatet me buxhetin, por është buxheti që duhet të përshtatet për të bërë të mundur zbatimin e Kushtetutës. Ka vite që drejtësisë shqiptare i kërkohet shumë dhe me të drejtë, integritet, profesionalizëm, shpejtësi dhe cilësi. I kërkohet të luftojë korrupsionin, të mbrojë të drejtat e qytetarëve dhe të jetë një nga shtyllat e procesit të integrimit evropian.

Pikërisht sepse kërkesat ndaj drejtësisë janë kaq të larta, po aq i lartë duhet të jetë standardi, me të cilin shteti garanton kushtet e ushtrimit të saj. Nuk mund t'i kërkojë drejtësisë të jetë e fortë dhe njëkohësisht të dobësosh institucionet, që duhet ta japin atë; t'i kërkojë gjyqtarit pavarësi dhe ta trajtojnë statusin e tij si të negociueshëm; t'i kërkojë administratës të mbajë sistemin në këmbë dhe ta lësh pa pagë. Nuk mund t'i kërkojë qytetarit të besojë te drejtësia, ndërsa vetë shteti i transmeton mesazhin se gjyqësori është barrë, problem apo kundërshtar”, - u shpreh Sadushi ndër të tjera, duke lënë të kuptohet një ndjesi zhgënjimi ndaj Ramës, i cili, pavarësisht mbështetjes dhe vlerësimeve të shprehura, nuk ka lejuar asnjë lëvizje për pagat.

Kujtojmë se ngërçi për pagat e gjyqtarëve ka sjellë prej muajsh përplasje mes qeverisë dhe sistemit të drejtësisë. Debatimi nisi pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për mënyrën e përllogaritjes së pagave të magjistratëve, i cili kërkonte ndërhyrje ligjore nga Kuvendi. Me përfundimin e afatit më 31 korrik pa u miratuar ndryshimet e nevojshme, u krijua një situatë e paqartë për pagat që do të zbatoheshin nga 1 gushti.

Në këtë situatë, KLGJ dhe KLP përcaktuan vetë mënyrën e vijimit të pagesave, ndërsa ekzekutivi ka argumentuar se pa një bazë të re ligjore nuk mund të bëhej përllogaritja sipas kërkesave të gjyqësorit. Përplasja u përshkallëzua pasi pagat e gushtit nuk u ekzekutuan, duke sjellë edhe protesta e ndërprerje të shërbimeve nga administrata e disa gjykatave.

Nga ana e tij, gjyqësori këmbëngul se vendimi i Gjykatës Kushtetuese duhet të zbatohet dhe se mungesa e një rregullimi të ri ligjor nuk mund të përdoret si arsye për të pezulluar një të drejtë që buron nga Kushtetuta.

LEJO EDHE:

Etiketa: [gjyqtarembledhjepagat e drejtësisë](#)

Lajme të lidhura



[Ngërçi me pagat/ Magjistratët kallëzojnë në SPAK, Petrit Malajn dhe drejtuesit e Thesarit në rrethë](#)

[11:41 : 10/09/2026](#)



[Rama takim me drejtuesit politikë/ Mbledhje me dyer të mbyllura te "Vila e Kuqe"](#)

[11:08 : 09/09/2026](#)




[Përplasja për pagat/ Gjyqtarët dhe prokurorët akuzojnë Financat për shkelje: Po zbatojnë formulë të shfuqizuar](#)

20:12 : 05/09/2026



[Ndryshime në kabinet? Rama mbledh sot deputetët dhe ministrat, çfarë pritet](#)

08:18 : 03/09/2026



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.